

## NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore në Prizren, Departamenti për Krime të Rënda, në trupin gjykues në përbërje prej gjyqtarës Raima Elezi, si kryetare dhe gjyqtarëve Gjimshit Galushi dhe Luan Berisha, si anëtarë, me sekretaren juridike Valdete Zurnaxhiu, në lëndën penale kundër të akuzuarit K. L. , nga Prizreni, për shkak të veprës penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 të KP-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren, Departamenti për Krime të Rënda PP.nr.268/14 e datës 30.09.2015 ,të precizuar në shqyrtimin kryesor, në fjalën përfundimtare me datën 31.10.2016, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor publik në praninë e Prokurorit të Shtetit në Prizren Mehdi Sefa, të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij av. N. E. nga Prizreni, me datë 02.11.2016 publikisht mori dhe shpalli këtë:

### A K T G J Y K I M

#### I akuzuari:

**K. L.** , nga i ati M. dhe e ëma M., e lindur K., i lindur më ... në Prizren, ku edhe tani jeton, Rr. “ ..... ” nr. ... , ka të kryer shkollën e mesme, me profesion oficer korrektues, i martuar, baba i dy fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

Në bazë të nenit 364 par. 1 nënpar. 1.3 të KPP.

### LIROHET NGA AKUZA

Se gjatë periodës kohore maj – gusht 2014 në kohë të pacaktuar në Qendrën e paraburgimit në Prizren në cilësinë e personit zyrtar oficer korrektues duke shfrytëzuar detyrën apo autoritetin zyrtar, i tejkalon kompetencat e tij me qëllim të përfitimit të dobisë për vete dhe personat tjerë të paraburgosurve B. B. dhe N. K., në atë mënyrë që jep në përdorim dhe shfrytëzim telefona mobil të markës “Nokia” dhe “Samsung”, medikamente , cigare për shuma të caktuar të parave 150-200 € të paraburgosurve B. B. dhe N. K., këto shërbime ka realizuar përmes kontakteve telefonike që ka pasur me djalin e B. , L. dhe djalin e N. , I. dhe vendtakimi i tyre ka qenë tek restoranti “H.” gjë që vërtetohet nga hyrjedalje të bisedave telefonike e të akuzuarit K. me këta persona,

-me këtë do të kishte kryer veprën penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 të KP,

Në interes të përgjithshëm konfiskohen telefonat celular “Samsung”, ngjyrë të zezë, telefon “Motorola”, ngjyrë e zezë, adapter telefonit ngjyrë të zezë, telefon “Samsung” ngjyrë e zezë, telefon “Nokia” ngjyrë të zezë, dy adapter ngjyrë e zezë dhe një SIM kartel “Vala”900.

Shpenzimet e procedurës penale bien në barë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

## A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren- Departamenti për Krime të Rënda, ka ngritur aktakuzën PP.nr. 268/14 e datës 30.09.2015, kundër të akuzuarit K. L. nga Prizreni, për shkak të veprës penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par. 1 të KP-së.

Në fjalën përfundimtare ka mbetur pranë aktakuzës duke precizuar gjendjen faktike të cekur në aktakuzë, në mënyrë që ka zgjatur periudhën kohore në atë maj – gusht; në rreshtin e V të dispozitivit pas fjalës N. K. , ka hequr fjalinë “duke shkaktuar qëllimisht dëm personit tjetër organit të Qendrës së paraburgimit në Prizren” dhe ka precizuar telefonat mobil duke i cekur markat “Nokia” dhe “Samsung”. Ka shtruar se gjendjen e këtillë faktike e mbështet në veçanti në deklaratën e dëshmitarit I. H. , i cili ka theksuar se ka qenë në të njëjtën dhomë me B. B. dhe se një mëngjese ka parë këtu të akuzuarin së bashku me B. kur kanë hyrë në banjë të dhomës dhe pasi kanë dalë B. i ka treguar telefonin mobil të cilin më herët nuk e kishte duke thanë se telefonin ia ka dhanë oficeri korrektues, i akuzuari K.L. , si dhe në deklaratën e dëshmitarit A. B. , të cilat deklarata janë në përputhshmëri të plotë edhe me përgjimet hyrje daljeve të bisedave telefonike në mes të akuzuarit me paraburgosurit B. B. dhe N. K. si dhe me djemtë e tyre, e që pas bastisjes të kryer në dhoma e këtyre paraburgosurve janë gjetur telefonat mobil. Po ashtu në mbështetjen e aktakuzës është edhe pjesa e deklaratës së të akuzuarit i cili ka pranuar kontaktet telefonike që ka pasur me të paraburgosurit në fjalë dhe djemtë e tyre dhe shërbimet që i ka kryer përmes porosive të cilat i ka pranuar çoftë nga të paraburgosurit çoftë nga djemtë e tyre. Konsideron se në veprimet e të akuzuarit formohet të gjitha elementet e veprës penale për cilën akuzohet sepse i akuzuari në cilësinë e personit zyrtar ka shfrytëzuar këto autoritete, me qëllim të përfitimit të dobisë për vete dhe të tjerëve duke tejkalluar kompetencat e veta, me propozon që i njëjti të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit. Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin kërkon nga gjykata të merr parasysht të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 73 , të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit edhe atë shkallën e rrezikshmërisë së kësaj vepre penale meqenëse shihet qartë se i akuzuari ka kryer disa veprime që atij nuk i takojnë, pra ka marrë disa kompetenca të cilat i ka vet gjyqtari i procedurës paraprake gjatë mbikëqyrjes së hetimeve, andaj vepra si të tilla nuk mund të kalojnë pa u ndëshkuar.

Mbrojtësi i të akuzuarit av. N. E. në fjalën përfundimtare me shkrim ka theksuar se të gjitha provat e administruara nga ana e subjekteve procedurale kanë arritur të provojnë vetëm një fakt, ekzistimin e shkeljeve të dispozitave nga marrëdhënia e punës të vërtetuar si në vendim e komisionit të Institucionit, ku ka punuar i mbrojturi i tij. Aktakuza e Prokurorisë bazohet në dy deklarata të dy të paraburgosurve A. B. dhe I.H. , të cilit vetëm kanë dëgjuar rrethanën e furnizimit me telefona mobil për të paraburgosurin B. B. , se kinse e ka bërë i mbrojturi i tij K. L. , pa marrë në pyetje dëshmitarët T. G., B. B. për të provuar thëniet kuturu të dy dëshmitarëve A. B. dhe I. H. . Konsideron se nuk është provuar fakti themelor se i mbrojturi i tij e ka furnizuar T. G. apo B. B. me dy telefona mobil të zënë me aktin e bastisjes nga ana e Institucionit, e as nuk janë provuar tre elemente themelore të cilat kërkojnë në bazë të ligjit edhe atë përfitimi pasuror në shumë prej 200 – 250 €, vendi i kryerjes së veprës penale përkundër rrethanës se sipas aktakuzës ka qenë pavijoni C, e në periudhën indikativë i

mbrojturi i tij ka qenë në pushim dhe nuk ka qenë i sistemuar në atë pavijon, si dhe koha e kryerjes e kësaj vepre penale. Përveç kësaj edhe me dëgjimin e dëshmitarëve B. B. , N. K., Sh. K. , Gj. K. dhe Sh. P. , është vërtetuar fakti se i mbrojturi i tij ka qenë korrekt në punë dhe asnjëherë nuk ka rënë në kundërshtim me ligjin. Në shqyrtimin kryesor ka shtuar se vet prezantimi i provave ka mbetur në suazat e shkeljes disiplinore që i mbrojturi i tij ka pranuar me ç raste edhe ndaj tij është shqiptuar masa administrative sepse mungon përfitimi pasuror nga ana e të mbrojturit të tij, e as prova se ka furnizuar ndonjërin nga të paraburgosurit me telefon. Deklaratat e dy dëshmitarëve, dy të paraburgosurve të cilat përfaqësuesi i akuzës ka cilësuar si prova bindshme, janë deklarata të nxjerra në gjithsej tre rreshta, ku në përmbajtje theksojnë “ kemi dëgjuar se T. ka pas problem me B. për një telefon të cilën K. ia kishte dhanë B.” . Andaj propozon që konformë nenit 364 par. 1 pik., 1.3 të KPP ndaj të mbrojturit të tij të merret aktgjykimi lirues pasi që nuk është provuar se i mbrojturi i tij ka kryer veprën penale.

I akuzuari K. L. ne mbrojtjen e vet ka deklaruar se prej datë 06.08.2007 deri më sot punon si oficer korrektues në Qendrën e Paraburgimit në Prizren. Detyrat e tij janë kujdesi për sjelljen e të paraburgosurve gjatë qëndrimit të tyre nëpër dhoma , përcjellja gjatë shëtitjes, ushqimit, përcjellja deri në pjesën e caktuar për dërgim në mjekim apo në gjykatë, për vizita familjare dhe të gjitha këto detyra i kryejnë sipas rregullores së brendshme të punës në Qendrën e Paraburgimit. Në bazë të këtyre rregullave si oficer korrektues lejohet komunikimi me të paraburgosurit ndërsa, futja brenda e sendeve të ndryshme si barna mjekësore, telefona mobil, kartela telefonike, adaptera të telefonave, të gjitha rreptësishtë janë të ndaluara sepse barnat mjekësore i sjell tekniku medicinal i cili është përgjegjës. Për arsye humane ka dërguar në raste të rralla pako me cigare ose medikamente mjekësore për kokë dhimbje si Sulidamor dhe OK, të cilat zakonisht i mban pran vetes sepse i shfrytëzon edhe vetë për kokë dhimbje. I njeh N. K. dhe B. B. si të paraburgosur në Qendrën e Paraburgimit në Prizren dhe ka komunikuar me ta, ka pasur raportet të mira me familjarët e tyre, me djalin e N., me emër I. është takuar afër Qendrës së Paraburgimit dhe ka komunikuar përmes telefonit, është takuar dhe biseduar me telefon edhe me djalin e B.B. . I ka sjellë barna mjekësore Sulidamor të cilat ia ka përcjellë N. K. dhe përkundër asaj që ka ditur se me këtë po i shkel rregullat e brendshme të Institucionit. Djali i B. disa herë i ka dhënë 3-4 pako cigare për babanë e tij B. , por me rastin e futjes së këtyre gjërave ka qenë i kontrolluar nga ana e mbikëqyrësit të lartë Xh. K. . Me datë 05.06.2014 në dhomën e B. B. gjatë bastisjes është zënë një telefon mobil, mirëpo në atë kohë ka qenë në pushim javor. Të gjitha komunikimet që ka pasur me I. dhe L. kanë qenë lidhur me medikamente dhe cigare. Është e vërtetë se N. K. e ka thirrë me telefon të operatorit “Vala” ose “Ipko” dhe e ka pyetur kur është në punë, për ta furnizuar me medikamente, kur i ka thënë se kur të kthehet në punë, do t’ia sjellë ato nëse ia siguron djali i tij I. . Me datën 04.08.2014 rreth orës 18:10 minuta ka qenë duke vozitur automjetin kur ka thirrur djali i N. , I. dhe ka kërkuar që ta përcjellë një adapter, i ka thënë që porosinë të lë te banaku i restorantit “Halimi”, ku ka punuar si punë e dytë, duke i thënë “rri pa ves sepse do të shkojë dhe do ta marrë aty”, mirëpo nuk i ka dërguar adapterin. Nuk ka ditur se N. ka poseduar apo jo telefon në Qendrën e Paraburgimit, nuk ka ditur as nga cili telefon ai e thërriste. Është i vetëdijshëm se ka bërë gabim, edhe atë nga pakujdesia duke lejuar që ta thërrasin me telefon dhe të komunikojë në këtë mënyrë me ta. Për këto shërbime me medikamente dhe cigare nuk ka marrë asnjë shpërblim asnjëherë, madje nuk ka pranuar as një kafe bile. Është i vetëdijshëm që ka shkelur rregullat e Qendrës së Paraburgimit por kjo ka qenë nga neglizhenca dhe pakujdesia duke mos pasur asnjë përfitim.

Gjykata ka administruar provat të propozuara me dëgjimin e dëshmitarëve A. B. , I. H. , N.K. , B. B. , L. B., Sh. K. , S. P., T. G., A. Sh., Xh. T., Sh. K. dhe I. K. si dhe provat materiale listingu i thirrjeve, SMS, hyre dalje dhe hartografi, të operatorit kompanisë “Ipko”, informacioni i zyrës PTK për veprim të kërkesave ligjore, informacioni operatorit “Vala”, foto albumi, lista e dëshmimeve, raporti i Qendrës së Paraburgimit Prizren, zinxhiri i ruajtjes lidhur me telefonat të cilat janë objekt i aktakuzës , mendimi i Ministrisë së Drejtësisë Shërbimi Korrektues i Kosovës QP në Prizren .

Gjatë shqyrtimit kryesor është realizuar listingu i thirrjeve, SMS, hyrje-dalje dhe hartografia e numrit 049 ... .. për periudhën kohore 21.06.2014 deri në 21.08.2014 të kompanisë mobile “Ipko”. Nga i cili vërtetohet se i akuzuari ka kontaktuar me numrat e telefonave shfrytëzuesit L. B. , I. K. dhe N.K. .

Është lexuar informacioni i zyrës PTK për veprim të kërkesave ligjore ZKL ..../. të datës 28.08.2014 dhe 2112/14 të datës 09.07.2015.

Është lexuar informacioni i operatorit “Vala” për numrin e telefonit 044 ... .. të datës 29.08.2014 dhe 25.07.2014.

Është bërë shikimi në foto albumi i njësisë së forenzikës me nr. ....-GI.. të datës 27.10.2014 dhe 05.06.2014.

Është lexuar lista e dëshmimeve e datës 05.06.2014 me një CD me përmbajtje hyrje-dalje telefonike.

Është lexuar raporti i Qendrës së Paraburgimit në Prizren 04.03.2016, nga e cila shihet orari i punës për periudhën 01.05.2014 deri më 30.06.2014 për oficerin korrektues K. L. , nga e cila vërtetohet se muajin maj deri më 16. qershor .2014 ka punuar në krahun 0 dhe A ndërsa deri më datën 30.qershor në krahun B në pjesën banuese.

Është bërë shikimi në zinxhirin e ruajtjes nr. rastit ....-GI.. të datës 10.06.2014 së bashku me listën e dëshmimeve me nr. dhe datë të njëjtë në të cilën janë prova me përshkrim të artikullit telefon celular “Samsung” ngjyrë e zezë, telefon “Motorola” ngjyrë e zezë, adapteri telefonit ngjyrë e zezë, kuti i drurit të lojërave domino, peshqir me ngjyrë të bardhë, pako cigare prestigj dhe një qese të najlonit me ngjyrë të zezë dhe EV2 lidhur me rastin me numër të njëjtë ku janë evidentuar telefon “Samsung” ngjyrë e zezë, telefon “Nokia” ngjyrë e zezë, adapteri ngjyrë e zezë, adapteri ngjyrë e zezë dhe SIM kartela “Vala 900”.

Është lexuar vendimi i Ministrisë së Drejtësisë, Shërbimi korrektues i Kosovës, Qendra e paraburgimit në Prizren nr. 04 të datës 08.01.2016, nga i cili vërtetohet se zyrtar korrektues në QP Prizren K. L. ka kryer shkeljet e rregullave të brendshme të punës të paraparë me Rregulloren e brendshme të punës 2007, kapitulli 9.2 standardi i 4 pika (C)- hynë në marrëdhënie pune apo personale me një të burgosur, me familjen apo miqtë e të burgosurit pa aprovimin e eprorit kompetentë të tij; pika (F) -jep apo pranon mall kontrabande në mënyrë direkte apo indirekte nga një i burgosur apo familja ose miqtë e të burgosurit; pika (G)- fut apo nxjerr nga burgu kontrabandë apo sendet të palejuara, të cilat shkeljet janë konstatuara nga komisioni disiplinor pas shqyrtimit dhe verifikimit të fakteve, në bazë të cilave është shqiptuar masa disiplinore me të cilën K. L. është i suspenduar sipas vendimit nr. ... të datës 02.10.2015.

Gjykata me provat e administruara në mënyrë të besueshme ka vërtetuar se i akuzuari K. L. punon qe 10 vjet si oficer korrektues pranë QP në Prizren, gjatë vitit 2014 ka punuar në krahun banues dhe se në atë pjesë nuk është e lejueshme që oficeret korrektues të posedojnë telefona, me rastin e hyrjes në atë pjesë ata duhet të kalojnë disa pika të kontrollit, se i akuzuari ka komunikuar me telefon drejtpërdrejtë me të dënuarin N. K. dhe djalin e tij I. , po ashtu edhe me të paraburgosurin B. B. dhe me birin e tij L., se disa herë me kërkesën e L. B. ka dërguar cigare dhe atë 3 – 4 pako për prindin e tij B.B. , ndërsa për N. K. ka dërguar medikamente për dhimbje koke – sulidamor dhe OK.

Këto fakte janë vërtetuar në bazë të mbrojtjes së të akuzuarit si dhe në bazë të deklaratave të dëshmitarëve. Në atë drejtim dëshmitari L. B. ka dëshmuar se e njeh gardianin K. L. sepse disa herë ka qenë në restorantin “H.”, i cili gjendet në rrugë për në Arbanë . Gjatë bisedës me një kamerier ai ka treguar se K. punon edhe si gardian në QP në Prizren, por edhe si kamerier në atë restorant, ashtu që e ka lutur K. që t’i dërgon babait të tij 5 pako cigare të markës “Marllboro Light” , ai me vështirësi ka pranuar, por a ka dërguar nuk e di dhe për këtë shërbim nuk ka kërkuar asgjë. Përveç në restorant “Halimi” me K. është takuar edhe tek marketi “Kastrati”, edhe atë rastësisht, ka ndodhur që ka biseduar edhe përmes telefonit . Dëshmitari I. K. ka dëshmuar se që nga koha e pas luftës e njeh K. se i ka daj të në Suharekë dhe me këtë ka pasur vetëm përshëndetje, ka ditur që K. ka punuar në restorant “H.” mirëpo gjatë vizitave në Qendrën e Paraburgimit në Prizren te babai ka parë që ai punon në atë qendër. Ka ndodhur një apo dy herë që ka kërkuar prej K. që t’ia dërgojë medikament Sulidamor për kokë dhimbje dhe këtë ka bërë në mënyrë humane. Dëshmitari Sh. P. në deklaratën e vet ka theksuar se në hyrje të pjesës banuese ku kalojnë të gjithë oficerët ekziston detektori statik dhe një oficer i cili qëndron me detyrë për kontrole dhe për hapjen e derës për pjesën banuese, pra të gjithë ata që kanë punë në pjesën banuese duhen t’i nënshtrohen kontrollit në atë mënyrë, oficeri korrektues nëse është oficeri kujdestar i krahut, ka për detyrë të hap derën, të mbyllë derën të bënë kontrollin e sigurimit bashkë me një oficer tjetër në qoftë se ka kujdestarë, mirëpo nëse nuk ka kujdestarë kontrollin e bënë vetë ai. Se i akuzuari K. L. ka komunikuar me të paraburgosurit dhe bijtë e tyre ka dëshmuar edhe dëshmitari Sh.K. i cili ka hetuar rastin dhe në bazë të urdhëresës së gjykatës e ka bërë përgjimin e telekomunikimeve , i kujtohet që ka punuar në bazë të tri urdhëresave. Gjatë zbatimit të urdhëresave kanë vërtetuar se i akuzuari ka pasur dy numra të telefonave 049 ... .. të kompanisë Ipko dhe 044 ... .. të kompanisë Vala, me të cilat ka komunikuar me të burgosurit N. K. në numrin e tij të telefonit 049 ... .. , gjithsejtë 24 telefonata për periudhën 60 ditore. Kanë arritur që të vërtetojnë se K. ka komunikuar edhe me L. B., djalin e të paraburgosurit B. i cili ka poseduar nr. telefonit 049 ... .. dhe oficeri korrektues K. ka furnizuar me cigare B. sa herë që ka pasur nevojë, po ashtu kanë identifikuar se oficeri K. ka komunikuar edhe me personin I. K., djalin e të paraburgosurit N. K., në bisedë në mes tyre kanë kuptuar se I. kërkon nga K. të kryejë disa shërbime, edhe atë me gjëra ushqimore, barna si dhe një adapter të telefonit dhe në këtë bisedë K. i drejtohet I. që adapterin ta lë te restorant H. dhe kur të shkojë në punë, do ta kryejë edhe atë punë pa problem. Këto biseda lidhur me adapterin janë zhvilluar më 04.08.2014 në ora 18:10 minuta, ndërsa bisedat në mes K., B. ,L., I. dhe N. me datë 21.07.2014, në bisedë me L. K. i drejtohet atij duke i thënë “do cigare po lyp ai” duke mos përmendur emrin, ndërsa L. thotë ia kam dërguar mbrëmë. Ekziston edhe biseda ku K. i refuzon marrjen e cigareve duke thënë se është në ndërrimin e natës dhe nuk mund të dërgojë cigare. Në bazë të provave materiale dhe atë duke u bazuar në telefonatat që janë bërë, në bazë të porosisë për mbushësin e telefonit, të përmendur gjatë bisedës, si dhe furnizimin me gjërat e ndryshme ushqimore, barna dhe komunikime me të paraburgosurit dhe me familjarët e tyre, kanë konstatuar se oficeri korrektuese në mënyrë të vetëdijshme ka keqpërdorë autorizimin zyrtar apo pozitën zyrtare duke mos vepruar në

parandalime e dukurive të përmendura, duke mos e lajmëruar mbikëqyrësin e tij apo eprorin, e shfrytëzon telefonin mobil në mënyrë të kundërligjshme, prandaj kanë paraqitur kallëzimin penal. Gjatë bisedave nuk është përmendur telefoni celular mirëpo gjatë zhvillimit të hetimeve janë intervistuar disa paraburgosur në cilësi të dëshmitarëve I. H. , A. B. dhe disa të tjerë të cilët kanë dëshmuar se prej kujt kanë ardhur ata telefona dhe kush e furnizon duke përmendur emrin K. L. .

Mirëpo lidhur me të dhënat nga akuza se i akuzuari K. L. ka keqpërdorur pozitën zyrtare duke tejkaluar kufijtë e autorizimit zyrtar, me qëllim që vetes dhe tjetrit t'i sjellë dobi të kundërligjshme pasurore, në mënyrë që B. B. dhe N. K. u ka siguruar telefona celular, për shumën prej 150 – 200 €, gjykata me verifikimin e besueshmërisë së provave përmes kontrollit logjik, ka bërë krahasimin e deklaratave të kundërta të dëshmitarëve A. B. dhe I. H. , prova këto në të cilat prokurori bazon akuzën e vet , me deklaratën e B.B. i cili nuk ka mohuar se telefoni i cili është gjetur në dhomën C5, është i tij , duke dhënë versionin e vet se në çfarë mënyrë ka ardhur deri te ky telefon. Në bazë të këtyre deklaratave është vërtetuar në mënyrë të pakontestueshme se me datën 05.06.2014 pas vizitës familjare, në mes të rrobave të destinuara për të paraburgosurin A. M. , është gjetur një telefon, prandaj, në bazë të urdhrit të drejtorit edhe është bërë një kontroll në dhomën C5 , ku ka qenë i vendosur A. M. bashkë me I. H. , B. B. , I. G. dhe M. C. . Në këtë dhomë gjatë kontrollit është gjetur një telefon mobil i markës “Samsung” i cili ka qenë pronë e B. B.. Këtë faktë gjykata ka vërtetuar në bazë të deklaratës së dëshmitarit Sh. K., i cili në mes tjerash ka deklaruar se sa i kujtohet në periudhën kohore qershor – gusht 2014 ka qenë një kontrabandim i zbuluar nga stafi i vizitave kur është gjetur një telefon dhe në bazë të urdhrit nga drejtori është bërë bastisja edhe në një dhomë ku është gjetur një telefon. Sipas procedurave dhe rregullave të institucionit është caktuar ekipi për hetim lidhur me dy raste ku në atë ekip ka qenë edhe ai së bashku me M. Z. dhe mbikëqyrësi i lartë Sh. P. , i kujtohet që dhoma ka qenë në krahun C por nuk e di numrin, në atë dhomë kanë qenë të vendosur të paraburgosurit I. H. dhe B. B. . Dëshmitari Sh. P. ka dëshmuar se ka qenë pjesë e ekipit e cila ka bërë bastisjen në dhomën C5, në të cilën është gjetur një telefon dhe se arsyeja që atë ditë është bërë bastisja në pavijonin C ka qenë sepse gjatë vizitës familjare përmes të rrobave është tentuar të futet një telefon celular por nuk i kujtohet kush prej paraburgosurve ka pasur vizitë. Dëshmitari Xh. K. në atë drejtim ka dëshmuar se në periudhën kohore maj – qershor 2014 ka punuar si udhëheqës i nderimit të oficerëve korrektuese në pozitë mbikëqyrësi i lartë në QP Prizren ku punon edhe sot dhe se përveç bastisjes të rregullta kanë edhe bastisje të qëllimshme dhe se i kujtohet që te paraburgosuri B. B. është gjetur një telefon mobil. Fakti se telefoni i gjetur në dhomën C5 ka qenë pronë e B. B. nuk ka mohuar as vet dëshmitari B. , duke theksuar se është e vërtet që ka poseduar një telefon celular por nuk i kujtohet marka. Ditën kritike kur është bërë bastisja ka pasur vizitë familjare dhe pasi është kthyer në dhomë një oficer , nuk i kujtohet emri i ka thanë se është gjetur një telefon në dhomë.

Mirëpo duke pasur parasysh tërë zhvillimin e ngjarjes , pranë kësaj edhe deklaratën e dëshmitarit A. B. i cili ka deklaruar se në vitin 2014 ka qenë në paraburgim në QP në Prizren dhe në atë kohë cimerët në dhomë kanë qenë T. G. , B. M. dhe B. Sh.dhe në atë kohë, në atë dhomë zyrtarët e qendrës kanë gjetur dy telefona, njeri ka qenë i tij i tipit “Samsung” të cilin e ka gjetur në dhomën C1, te ventilatori . Por nuk e din kush e ka lënë në atë vende ndërsa tjetri ka qenë i T. . Në bazë të kësaj gjykata vjen deri në konkluzion se kemi të bëjë me tre telefona, njeri “Samsung” për të cilin A. ka pranuar se është i tij dhe e ka gjetur në dhomë, pastaj telefoni tjetër “Nokia” për të cilin ai thotë se është i T. si dhe edhe një telefon “Samsung” i cili është gjetur në dhomën C5, për të cilin dëshmitari B. B. ka pranuar se është i veti. Parashtrohet pyetja se prokurori ku e bazon akuzën e vet që i akuzuari ka sjellë disa

telefona brenda objektit të QP, edhe atë një “Nokia” dhe një “Samsung”, kur dëshmitari A. B. ka pranuar se ky fundit ishte i tij . Përveç kësaj deklarata e dëshmitarit A.B. sa i përket furnizimit nga oficeri korrektues K. L. bazohet vetëm në atë çka ka dëgjuar duke dëshmuar se T. ka pasur problem me B. , edhe atë lidhur me një telefon, pasi që T. ka blerë një telefon prej B. në shumë prej 200 € , pastaj B. ka kërkuar që të ia kthejë telefonin, por personalisht nuk ka parë se T. ka paguar 200 €, por këtë vetëm ka dëgjuar, madje asnjëherë nuk ka qenë në të njëjtën dhomë me B. i cili ka qenë i vendosur në dhomën C5 dhe prej dhomës C1 nuk mund të vërehet kush hynë në dhomën C5. E vetmja provë në të cilën bazohet akuza është deklarata e dëshmitarit I. H. i cili ka deklaruar se ka qenë i vendosur në dhomën C5 së bashku me B. B. , I. G. , A.B. dhe M. C., i kujtohet se në atë dhomë pas një bastisjeje është gjetur një telefon mobil i B. i markës “Samsung” dhe lidhur me këtë i kujtohet që në muajin maj të vitit 2014 në mëngjes shokët e dhomës I. G. dhe A. B. kanë shkuar për të grenë mëngjesin dhe ka vërejtur kur oficeri korrektues K. L. së bashku me B. kanë hyrë në banjë të dhomës dhe kur K. ka dal B. ka thanë se telefonin e ka në xhep dhe se e ka marr prej K. i cili është paguar jashtë nga djali i tij L. në shumë prej 200 – 250 € duke shtuar se në fakt është folur në mes të paraburgosurve se nëse dikush dëshiron të furnizohet me telefon mund ta bëjë me çmim prej 200 – 250 € përmes oficerit korrektues K. L. .

Mirëpo kjo deklaratë e dëshmitarit është mohuar me deklaratën e dëshmitarin B.B. i cili ka dëshmuar se atë telefon ia ka sjellë mbikëqyrësi Xh. dhe e ka poseduar përafërsisht 2 muaj, Xh. shpesh e ka thirrur në zyrë për të pirë kafe dhe kanë bërë bisedë se ka nevojë për një telefon. Në fillim Xh. i ka thanë se është vështirë për të siguruar telefonin por pas një jave e ka thirrur në zyrën e tij , e ka shërbyer me një kafe turke dhe pasi e ka pyetur se çka është puna e telefonit, Xh. e ka pyetur se para është në gjendje të japë për atë shërbim, kur ia ka përmendur 200 €, ai ka kërkuar 250€. Kështu janë marrë vesh që të hollat për këtë shërbim të ia japë një shoku i tij S. D. nga fshati Z. . Së pari ka biseduar me S. me telefonin e të paraburgosurit F., marrëveshja ishte që S. dhe Xh. të takohen afër ndërtesës së Prokurorisë ku do të dorëzohen ato 250 €. Të nesërmen S. ka ardhur afër prokurorisë, i ka dhënë parat prej 250 € dhe telefonin dhe në mëngjes pasi Xh. është mbikëqyrës i pavijonit, rrethe orës 08:30 – 08:40 e ka ftuar në zyrë përmes një oficer tjetër , ku e ka shërbyer me një kafe dhe ia ka dhanë telefonin bashkë me mbushësin duke i thanë “ fute në xhep mos të sheh askush”. Me asnjë paraburgosur nuk ka pasur bisedë lidhur me mënyrën e sjelljes së telefonit, përveç kësaj prej kohës kur është vendosur në paraburgim është njoftuar me Xh. dhe ka ndodhur që i njëjti t’i sjellë mish për ushqim, për të cilën shërbim ka kërkuar 20 €, mirëpo më vonë ka prishur raportet me Xh. sepse për ndonjë shërbim ka kërkuar më shumë para, psh për gjysmë litër alkool i ka kërkuar 50 €. Në fakt i paraburgosuri I. ka premtuar se do të marrë përgjegjësin mbi vete në rast se telefoni gjendet mirëpo nuk e ka mbajtur premtimin.

Se deklarata e dëshmitarit A. B. është e paqëndrueshme dhe është në kundërshtim me deklaratën e dëshmitarit T. G. i cili ka dëshmuar se gjatë periudhës kohore maj – qershor 2014 ka qenë i vendosur në krahun C në një dhomë së bashku me të paraburgosurit E. H., A. B. , B. K. dhe Gj. T. dhe se gjatë një bastisjeje është gjetur një telefon “Nokia” për të cilin ka dëgjuar se vetë e ka sjellë i paraburgosuri B. K., ndërsa telefonin e dytë të markës “Samsung” e ka prurë A. B. i cili ka furnizuar me telefon edhe të paraburgosurit e tjerë në atë mënyrë që bashkëpunëtori i tij nga jashtë paraprakisht ka rregulluar dhe sjellë familjes së A. në shtëpi kllompet të cilat familja ka sjellë në QP. Personalisht ka parë dy herë kur A. pas mesnate nga kllompa me ngjyrë të bardhë, e cila në pjesën e poshtme kanë qenë e butë, ka nxjerr telefonin , një herë ka qenë një telefon i vogël “Motorolla”, nuk e di kujt i ka shitur por herën e dytë ka parë kur ka nxjerr telefonin “Samsung” të cilin ka përdorur vet. A. ka shitur telefonat të paraburgosurve për kompensim prej 150 – 200 €, këtë bisedë ka dëgjuar në dhomën C1.

Disa herë ka bërë pyetje se si të reagojë nëse i gjendet telefoni, ai është përgjigjur se fajin do t'ia lejnë ndonjë gardiani. Atë ditë kur është gjetur telefoni gjatë bastisjes, pas dy orëve kanë shkuar për të dhënë deklaratë por para se të shkojnë A. non- stop ka insistuar te këta të paraburgosurit që fajin t'ia lejnë B. , mirëpo nuk është e vërtetë se B. ka sjellë telefonin në dhomë. Pas dhënies së deklaratës ka shkuar në dhomë dhe në atë momente A. i ka dhënë një mbushës pa tel për telefonin "Samsung" duke i thënë që edhe për këtë mbushës të tregojë se ia ka dhënë B. dhe se është i atij. Kur A. e ka nxjerr telefonin nga kllompa ka qenë prezent edhe A. Sh., të cilat A. i ka prerë pjesë-pjesë dhe i ka gjuajtur në tualet.

Në mbështetje të kësaj ka dëshmuar edhe dëshmitari A. Sh. i cili në mes tjerash ka theksuar se gjatë vitit 2014, një kohë ka qenë i vendosur në dhomën C1 me të paraburgosurit A. B., T. G. etj, dhe i kujtohet që A. pasi është kthyer nga vizita familjare, bashkë me tesha kanë qenë edhe papuçet dhe personalisht ka parë kur prej një papuçe ka nxjerrë njëtelefonin. Telefoni ka qenë i vendosur në pjesën e takës e papuçeve e cilaka qenë më e gjer dhe ë të ishte vendosur telefoni, ajo pjesë ka qenë e mbuluar dhe nuk është vërejtur. Në fakt A. me anë të shkrepësës e ka shkrirë ngjitësin në atë pjesë të takes të cilën e ka hapur dhe aty ka vërejtur që ka telefon. Pasi ka nxjerr telefonin atë pjesë ka mbuluar me silikon të cilin ka marrë prej paketimeve të vogla të sheqerit, bashkë me telefonin ka qenë edhe mbushës.

Gjykata nuk ka mund tu besojë deklaratave të këtyre dëshmitarëve të cilit secili në mënyrën e vet kanë dhënë versionin e dëshmisë lidhur me atë se kush ka furnizuar me telefona.

Duke pasur parasysh të cekurat më lartë, është vërtetuar në mënyrë jokontestuese se i akuzuari ka sjellë në Qendrën e Paraburgimit disa herë medikamente për kokë dhimbje "Sulidamor" dhe "OK" për N.K. si dhe cigare për B. B. , mirëpo me asnjë provë nuk është vërtetuar se për këto shërbime ai ka marrë ndonjë shpërblim dhe ai për këto veprime është përgjigjur në procedurën disiplinore të inicuar nga Institucioni përkatës, për shkelje të rregullave të brendshme të atij Institucioni. Marrë parasysh se detyra zyrtare është objekt i mbrojtjes edhe te veprat penale të keqpërdorimit të detyrës zyrtare edhe te procedurat disiplinore dhe kryesisht është e natyrës kuantitative dhe në të dy raste është fjala për sjellje të kundërligjshme të personave zyrtar në kryerjen e detyrës, me të cilat sjellje rrezikohet kryerja e drejtë dhe e ligjshme e asaj detyre. Vet detyra zyrtare është objekt i mbrojtjes te shkeljet disiplinore, kurse me veprat penale kundër detyrës zyrtare mbrohen vlerat e tjera të cilat në mënyrë alternative janë paraparë si veprime të kundërligjshme me të cilat shkelen vlerat e ndryshme dhe atë pasuria, liria dhe të drejtat e individit, prandaj marrë parasysh se i akuzuari është shpallur përgjegjës në procedurën disiplinore pranë institucionit ku punon, për sjellje të kundërligjshme në kryerjen e detyrës, e me provat e administruara nuk është provuar se ka kryer një veprim inkriminues të paraparë sipas ligjit si veprim alternativ i veprës penale keqpërdorim i detyrës zyrtare, gjykata ka nxjerrë konkluzion se në veprimet e të akuzuarit nuk janë formuar elementet e veprës penale për të cilën është akuzuar.

Pra kur në favor të të cekurave më lartë merret se elementi i veçantë, përkatësisht tipar i veprës penale keqpërdorimi i pozitës zyrtare, është qëllimi i caktuar i cili duhet ekzistuar tek kryesi i veprës penale në kohën e kryerjes dhe pa ekzistimit të këtij qëllimi nuk mund të jetë e kryer vepra penale. Shikuar rastin konkret, në bazë të provave të administruara edhe atë deklaratave të dëshmitarëve të dëgjuar, të propozuar nga ana e përfaqësuesit të akuzës dhe nga ana e mbrojtjes, gjykata nuk ka mund në mënyrë të sigurt të vërtetonte faktin se i akuzuari si oficer korrektues, e më qëllim që vetes dhe tjetrit t'i sjell përfitim të kundërligjshëm pasuror, ka furnizuar me telefona, medikamente apo cigare të paraburgosurit



B. B. dhe N. K. . Kjo sepse dëshmitë e dëshmitarëve I. H. dhe A. B. nuk kanë mbështetje në deklaratën e dëshmitarit B. B. dhe atë të N. K. , të cilat janë përgënjeshtuar me deklaratat e dëshmitarëve T.G. dhe A. Sh. dhe si të tilla nuk janë të bindshme për gjykatën, sepse kur merret parasysh ambienti në të cilin kanë qëndruar të paraburgosurit, kemi një situatë kur krijohet një mos durim në mes të banorëve të atij ambienti dhe mundësinë e ngarkimit të njëri tjetrit me ndonjë faj. Po që se shtohet se ata kanë deklaruar atë çfarë kanë dëgjuar prej dikujt e jo çfarë kanë parë me sy apo përjetuar në çfarëdo mënyrë, po ashtu edhe niveli i arsimimit të tyre, na tregon se deklaratat e tyre nuk mund të jenë të besueshme dhe të vërteta.

Duke pasur parasysh se nocioni penalo juridik keqpërdorimi i pozitës zyrtare, ka për bazë nocionin e përgjithshëm të keqpërdorimit por në kuptimin më të ngushtë, sepse keqpërdorimi është edhe tipar i shkeljeve disiplinore, përkatësisht shkeljeve të tjera të pozitës zyrtare. Në kuptimin penalo juridik keqpërdorimi përfshinë ato veprime të kundërligjshme të personave zyrtar në kryerjen e detyrës, të cilat përcillen me qëllimin për përfitim për vete apo tjetrin të dobisë pasurore, apo shkaktimin e dëmit personit tjetër. Në rastin konkret gjykata nuk ka vërtetuar ekzistimin e qëllimit të përcaktuar në akuzë.

Prandaj, nga të gjithë të cekurat më lartë gjykata ka ardhur deri te konkluzioni se në veprimet e të akuzuarit nuk formohen elementet e kësaj vepre penale për të cilën akuzohet dhe të njëjtin e ka liruar nga akuza në mungesë të provave.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është marrë në bazë të nenit 454 par. 1 të KPP.

Vendimi mbi konfiskimin e sendeve është marrë në bazë të dispozitës së nenit 69 të KPP.

Nga se u tha më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykim

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**  
**Departamenti i Krimeve të Rënda**  
**P.nr. 188/2015 me datë 02.11.2016**

**Sekretarja juridike,**  
**Valdete Zurnaxhiu**

**Përkthyesi gjyqësor**  
**Asnije Berisha**

**Kryetarja e trupit gjykues**  
**Raima Elezi**

**KËSHILLË JURIDIKE:** kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditëve, pas marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë – e nëpërmjet të kësaj gjykate.